

KARTELË INFORMATIVE

AL011051

1. Emri i shërbimit	Kërkesë për regjistrim treguesi gjeografik			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Shërbimi mund të përdoret për të aplikuar për regjistrimin e një treguesi gjeografik.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Me anë të këtij shërbimi, aplikanti mund të kërkojë regjistrimin e një treguesi gjeografik në mënyrë që të fitojë të drejtën e pronësisë dhe përdorimit të tij.			
4. A jam përfitues?	<p>Përfituesi i shërbimit është një "grup" i organizuar në formën e shoqatës, e cila pavarësisht nga forma e saj ligjore përbëhet kryesisht nga prodhuesit apo përpunuesit që punojnë me të njëjtin produkt.</p> <p>Një person i vetëm fizik ose juridik mund të trajtohet si një grup kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme:</p> <p>a) personi është i vetmi prodhues i gatshëm të paraqesë një kërkesë;</p> <p>b) për sa u përket emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, zona e përcaktuar gjeografike ka karakteristika, të cilat ndryshojnë dukshëm nga ato të zonave fqinje ose karakteristikat e produktit janë të ndryshme nga ato të prodhuara në zonat fqinje.</p> <p>Grupet e huaja të prodhuesve mund të depozitojnë aplikim, me kusht që e drejta mbi TGM ose EOM është dhënë në vendet e origjinës dhe nëse ato plotësojnë kërkesat e ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.</p>			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Kërkesë për regjistrim treguesi gjeografik	Aplikanti	Po
	2	Prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar.	Aplikanti	Po
	3	Lidhja midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik ose lidhja midis një cilësie të caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike.	Aplikanti	Po
	4	Çdo rregull specifik për etiketimin e produktit në fjalë.	Aplikanti	Po
	5	Dokumenti zyrtar që vërteton krijimin e grupit.	Aplikanti	Po
	6	Një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë.	Autoriteti vendor	Po
	7	Autorizim përfaqësimi, nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar.	Aplikanti	Po
	8	Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse.	Bankë	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtrakëve	E hënë- e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	5000 Lekë	Nuk ka		Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	9 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit			
10. Çfarë përfitoj?	Certifikatë regjistrimi treguesi gjeografik.			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Mbrojtja ligjore e TGJ fillon me regjistrimin në DPPI, me efekt nga data e depozitimit të aplikimit, është e pakufizuar në kohë dhe përfundon kur nuk ekziston më lidhja ndërmjet vetive e karakteristikave të mallrave dhe mjedisit gjeografik.			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, DPPI			

14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në: <i>E- albania: e-albania.al</i> <i>ADISA web: www.adisa.gov.al</i> <i>ADISA email: Informacion@adisa.gov.al</i> <i>DPPI web: www.dppm.gov.al</i> <i>Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118</i>	Orari <i>Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike:</i> <i>E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00</i>
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	<i>Në sportele</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Me postë</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Web-i i Institucionit</i> <input type="checkbox"/> <i>Me e-mail</i> <input type="checkbox"/> <i>Në platformën "Shqipëria që duam"</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Link: www.shqiperiaqeduam.al</i>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	<i>Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar;</i> <i>Kodi i Procedurave Administrative;</i> <i>VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, i ndryshuar";</i>	